



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 98/7 Prot

Tiranë, më 10/3 /2016

V E N D I M

Nr. 07 ,datë 10/3 /2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit, "Notere Majlinda Demollari", me nipt K41606040A.

V Ë R E J S E :

Në zbatim të Urdhrit nr. 09, datë 28.01.2016 është kryer hetim administrativ pranë subjektit kontrollues *Notere Majlinda Demollari* me objekt:

- Verifikim të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, të kontratave paraprake të shitjeve të ankuesit G. R, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar;
- Plotësimi i detyrimit për njoftim, (Nenet 21, 22) të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Në lidhje me objektin e parë të urdhrin nga hetimi administrativ i ushtruar pranë kontrolluesit, nuk u konstatuan shkelje dhe rezultoi së është vepruar në përputhje me legjislacionin specifik dhe në respektim të rregullave të mbrojtjes së të dhënave personale.

Në ankesën e depozituar pranë Zyrës së Komisionerit, ankuesi pretendonte se kontrolluesi ka përhapur të dhënat personale të subjekteve të të dhënave, të cilat janë palë të kontratave paraprake të shitjeve të lidhura, ndërmjet ankuesit si administrator shoqërie dhe blerësve të ndryshëm. Në ankesë kërkohej të verifikohej përhapja e kontratave (vërtetim njësie me origjinalin), të persona të paautorizuar pa pëlqimin e palëve në kontratë dhe në kundërshtim me ligjin.

Në provat e depozituara nga ankuesi rezultuan 32 kontrata paraprake të shitjeve nga të cilat 24 janë me vërtetim njësie me origjinalin dhe kanë datën 19.08.2013 ndërsa 8 prej tyre janë pa vërtetim njësie.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese, u krye verifikimi i Regjistrin të Përgjithshëm të Akteve dhe Veprimeve Noteriale të administruar nga kontrolluesi, sipas të cilit rezultoi se veprimet noteriale (vërtetim njësie me origjinalin) të kryera nga kontrolluesi ishin kërkuar nga vetë ankuesi (kjo u vërtetua nga nënshkrimi i tij në regjistrin e mësipërm). Në lidhje me 8 fotokopjet e kontratave paraprake të shitjeve ato rezultojnë që janë hartuar sipas kërkesës së palëve në këto kontrata.

Gjatë kryerjes së hetimit administrativ rezultoi se nuk ka prova shkresore për të lidhur veprimet e kontrolluesit me pretendimin e ankuesit për përhapje të të dhënave të tij.

Në lidhje me objektin e dytë të urdhrin, nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të KDIMDP-së dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit si edhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se nuk është përmbushur detyrimi për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Për shkeljen e konstatuar është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", në datë 29/02/2016 është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Në këtë seancë dëgjimore Notere Majlinda Demollari, deklaroi se:

- "*Nuk kam pasur dijeni për këtë detyrim ligjor, nuk e dija që ekzistonte një drejtori e tillë*".

Subjekti kontrollues "*Notere Majlinda Demollari*", sipas ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit është krijuar dhe ushtron aktivitetin e tij që prej datës 01.04.2004, Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, është miratuar dhe botuar në Fletoren Zyrtare dhe me kalimin e afatit ligjor përkatës, është bërë i njohur për të gjithë publikun dhe është i detyrueshëm për zbatim. Nga miratimi i këtij ligji deri në momentin e ushtrimit të këtij hetimi administrativ ka kaluar një kohë relativisht e gjatë dhe kontrolluesi ka pasur gjithë mundësinë për t'u njohur me ligjin dhe detyrimet e tij.

Për më tepër, në zbatim dhe të marrëveshjes së bashkëpunimit me Dhomën Kombëtare të Noterisë, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar trajnime të noterëve me qëllim informimin në përgjithësi mbi detyrimet në respektim të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, me aktet nënligjore dhe në veçanti mbi detyrim ligjor që kanë këto subjekte kontrolluese për të njoftuar për përpunimin e të dhënave personale për të cilat janë përgjegjëse.

Në paragrafin 1, të nenit 21, të ligjit të sipërcituar, parashikohet: "*...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji*".

Gjithashtu, bazuar në nenin 25/1 të ligjit të sipërcituar, parashikohet që kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë zyrën e Komisionerit. Me miratimin e ligjit, kontrolluesi nuk duhej të vazhdonte përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar Zyrën e Komisionerit.

Në këto kushte, konsiderohet shkelje serioze përpunimi i të dhënave personale pa njoftuar dhe pa u regjistruar më parë, në Regjistrin Qëndror të subjekteve kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit.

Si përfundim, shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronja "d" e Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë, si më poshtë:

- Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 10 000 deri në 500 000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkelja e konstatuar është serioze, ajo lidhet me të drejtën e subjekteve të të dhënave personale për t'u informuar se kush përpunon të dhëna personale, informimin si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit dhe parim bazë i mbrojtjes së të dhënave personale. Gjithashtu, bazohet në bashkëpunimin gjatë ushtrimit të hetimit administrativ si edhe reagimin e kontrolluesit për shkeljet e konstatuara.

PËR KËTO ARSYE :

Në zbatim të neneve 21, 29, 30, 31, 32/1, 39/1/d, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe nenit 72/3 të Ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative":

V E N D O S A :

1. Dënimin e kontrolluesit "*Notere Majlinda Demollari*" me gjobë, në vlerën **30 000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot në, 10 / 3 / 2016

